

## KONTRIBUTI I EL-MESUDIT DHE EL-IDRIZIT NË SHKENCËN E GJEOGRAFISË DHE HISTORISË

Dijetarët e epokës së artë islame, dhanë kontribut jashtëzakonisht të madh në zhvillimin e shkencës në përgjithësi, si dhe gjeografisë e historisë në veçanti. Këta dijetarë nuk i kufizuan studimet e tyre brenda kufijve të shtetit islam. Studimet e tyre i kaluan kufijtë e këtij shteti, ata panë edhe vende të tjera dhe kanë shkruar shumë libra në fushën e gjeografisë edhe të historisë për territoret jashtë kufijve të shtetit islam. Ata shkruan libra të karakterit gjeografik dhe historik për rajonet e Kinës, Europës, Azisë, Ishujve Lindorë të Oqeanit Atlantik dhe Indian etj.

Ndër dijetarët më të njohur të kësaj epoke janë edhe El-Mesudi, i njohur si “Herodoti i arabëve”, i cili ishte historian dhe udhëtar i shquar i shekullit X, si dhe El-Idrisi, i njohur për udhëtimet e tij në të gjithë Europën, Afrikën dhe Azinë. Më poshtë do mundohemi që t’i paraqesim arritjet shkencore të këtyre dy dijetarëve shumë të njohur myslimanë të periudhës së Mesjetës.

### El-Mesudi (871 – 957)

*Ebu’l Hasan Ali Ibn el-Husein Ibn Ali el-Mesudi, u lind dhe u edukua në Bagdad, gjatë kohës së kalifatit të udhëhequr nga El-Mutadid. Ishte pasardhës i shokut të Pejgamberit (a.s.), Abdullah Ibn Mesud-it. Është i njohur për kontributin e dhënë në fushën e gjeografisë, historisë dhe fizikës.*

Për këtë studiu nuk ka shumë informacione se si gjeti mbështetje për udhëtimet e tij të gjata si brenda vendeve islame ashtu edhe jashtë tyre. Disa hulumtues, duke përfshirë Lunde dhe Stone, hedhin dyshimin se El-Mesudi si shumë studiues të tjerë mund të ketë qenë pjesë e tregtisë. Gjatë jetës së tij ai vizitoi shumë vende të ndryshme të botës, më qëllim që t’i hulumtonte ato. Vendet të cilat i ka vizituar El-Mesudi, janë: qytetet e pasura bregdetare të Azisë Lindore, Afrikës Jugore, të ishujve perëndimorë në Oqeanin Paqësor, ishujve në Oqeanin Indian. Disa nga këto qytetet

janë: Dar es Salaam, Shofala, Kilwa, Mobasa, Pemba, Malindi, Mogadishu, në Afrikën Lindore; Aden, Hormuz, Basrah, Surat dhe Cochîn në Detin Arabik; Sri Lanka dhe Malacca në Oqeanin Indian etj.

Në qytetin Basra, ai shkroi përmbledhjen e parë historike rreth udhëtimeve të tij me titull “Muruj-el-Mezahabut ue el-Ma-Adin el-javahir”. Ky libër burimin e ka nga librat e studiuesve të vjetër grekë, të cilat i studioi gjatë qëndrimit të tij në Bagdad dhe në Damask. Në këtë libër, El-Mesudi jep shumë informacione teorike rreth gjeografisë botërore. “Muruj-el-Mezahabut ue el-Ma-Adin el-javahir” fillon me teoritë tradicionale që kishin përmendur grekët, si: forma e tokës, ndarja e kontinenteve dhe e deteve, përshkrimin e deteve sipas traditës greke që përfundon me Detin Abyssinian (Oqeani Indian). Oqeanin Indian e përshkruan si një masë e madhe e ujit, që e formojnë shtatë dete të lidhur me njëri-tjetrin, ku secili det ka emrin dhe karakteristikat e veta. Deti i shtatë ndodhej në pjesën lindore (Deti i Kinës). Ky koncept i ndarjes së detit është i ngjashëm me ndarjen kineze në 5 dete, në tokën e Zhou Kufeit. Gjithashtu në këtë përmbledhje, El-Mesudi përshkruan në mënyrë të detajuar ngjarjet interesante që kishte përjetuar, gjeografinë, vendbanimet si dhe ekologjinë e vendeve që kishte vizituar. Në këtë libër, ai tregon për kontaktet personale me hebrejtë, iranianët, indianët dhe të krishterët, si dhe bën një përshkrim të Kinës. Për këtë kryevepër ka mendime të ndryshme për origjinalitetin, pra është shkruar apo jo nga El-Mesudi. Njëri prej tyre është Ahmed Shboul, që konstaton se El-Mesudi e rishkroi librin “Muruj el-dhahab”. Versioni i tanishëm është ai i vitit 947 dhe nuk është rishikuar në vitin 956. Ndërsa Lunde dhe Stone theksojnë se El-Mesudi në librin “Kitab el-Tanbih va el-Ishraf” tregon se rishikimi i “Muruj el-dhahab” përmban 365 kapituj. Megjithatë, është për të ardhur keq që nga 34 librat e tij, të përmendur nga vetë ai në “Kitab el-Tanbih va el-Ishraf”, vetëm tri prej tyre kanë mbijetuar, përveç “Kitab el-Tanbih va el-Ishraf”.

Gjeografët myslimanë përshkrimet e deteve dhe të ishujve i fillonin me të dhënat e tyre, por shpesh këto të dhëna i pasuronin me informacione që i merrnin nga marinarët dhe detarët e kohës që lundronin në Oqeanin Indian. El-Mesudi për veprat e tij siguroi të dhëna të rëndësishme gjeografike rreth vijës bregdetare të botës së njohur deri atëherë. Këto të dhëna gjithashtu gjenden edhe në shënimet e studiuesit tjetër mysliman Ebu Zayd. Ajo që çudit gjeografët e shekullit X, ishin dërrasat e një anijeje që u gjetën pranë ishullit të Kretës, e që kishte ardhur nga Oqeani Indian. El-Mesudi me siguri e ka ditur që ky oqean nuk kishte lidhje me detin

Mesdhe. Pyetja që e shqetësonte më shumë, ishte se si u futën anijet në detin Mesdhe nga Oqeani Indian. Deti Mesdhe me Oqeanin Indian nuk kanë pasur lidhje me njëri – tjetrin, derisa u ndërtua kanali i Suezit në fund të shekullit XIX. Sipas Ebu Zaydit dhe El-Mesudit, dërrasat kaluan nga Deti i Kinës në Oqeanin Paqësor, pastaj nëpërmjet Detit të Beringut kaluan në Oqeanin e Ngrirë të Veriut (Arktik), më pas vazhduan në Detin Norvegjez, e vijuan në ngushticën e Gjibraltarit në Spanjë, për t’u futur në Detin Mesdhe. Po kjo rrugë ishte e pamundur për t’u përshkuar nga anijet e vogla të asaj periudhe. Pavarësisht këtyre mendimeve, Eba Zayd dhe El-Mesudi kontribuuan në kuptimin e gjeografisë së botës gjatë kohës së tyre.

Nga Basra, El-Mesudi shkoi në Damask, pastaj në Kajro. Këtu shkroi librin e tij të dytë me titull “Muruj el-Zaman”. Libri ishte i ndarë në tridhjetë vëllime. Në këtë kryevepër, ai shkruan për kulturat, praktikën dhe zakonet fetare të popujve që kishte vizituar, duke bërë disa vërejtje rreth qytetërimeve të tyre. Këtë libër e plotësoi me një shtesë tjetër, të cilin e titulloi “Kitab el-Ausat”. Në këtë shtesë ka përpiluar ngjarjet historike në mënyrë kronologjike. Në vitin 957 (viti i vdekjes së tij), El-Mesudi përfundoi librin e tij të fundit “Kitab el-Tanbih va el-Ishraf”, në të cilin dha një përmbledhje të librit të mëparshëm, si dhe një studim sistematik të ngjarjeve (errata). El-Mesudi shkroi edhe disa vepra të karakterit historik. Ai ishte hulumtuesi i parë në botë, që hulumtimet shkencore në fushën e historisë, i bëri me metodat empirike dhe induktive.

Disa herë është referuar si Herodoti dhe Plini (Gai Plin Sekundi) i arabëve. Duke prezantuar një vlerësim kritik të ngjarjeve historike, më këtë, ai filloi një ndryshim në artin e shkrimit historik, duke futur elementët e analizës, reflektimit dhe kritikës, të cilat më vonë u përmirësuan edhe më shumë nga Ibn Khalduni. Në veçanti, në “El-Tanbih” ai bën një studim sistematik të historisë, përkundrajt një perspektive të gjeografisë, sociologjisë, antropologjisë dhe ekologjisë. El-Mesudi bëri një pasqyrë të thellë për shkaqet e ngritjes dhe rënies së kombeve.

Herodoti, të cilit i parapriu El-Mesudi më shumë se njëmijë vjet më parë, ishte historiani i parë që u njoh me termin “historian”. Shkrimet e Herodotit ishin të bazuara në tregime, legjenda, mendime dhe shumë pak në fakte. Udhëtimet e tij në Babiloni, Persi dhe Egjipt për të mbledhur material për librat e tij, janë subjekt debati nga hulumtuesit që nga kohët e mëvonshme, e deri në kohët moderne. Herodoti nuk ka gjetur një shpjegim shkencor për ngjarjet historike në historitë e perëndive greke. Nga ana tjetër, vëzhgimet e El-Mesudit kanë argumentimet e tyre shkencore si në gjeografi, etnografi, ekologji, antropologji, ashtu dhe në histori. Ai gjen

fakte historike për punën dhe mjedisin ku ka jetuar njeriu gjatë historisë dhe nuk bazohet në fakte të mbinatyrshme. Metodologjia hulumtuese e tij ishte e bazuar në metodën induktive. Pas një takimi të hulumtuesve myslimanë, u pranua metoda induktive e El-Mesudit, si metodë bazë në hulumtimet e tyre të ardhshme, duke e larguar nga përdorimi metodologjinë deduktive të grekëve. Metoda empirike u takon myslimanëve, ashtu siç u takon metoda racionale grekëve. Nga kjo kuptojmë se El-Mesudi ishte shpikësi i metodës dhe i historiografisë empirike, pra nuk ishte Herodoti shpikësi i kësaj metode.

El-Mesudi punoi një hartë të botës së njohur deri atëherë. Kjo hartë ishte më e saktë dhe më e plotësuar se hartat e punuara më parë. Në këtë hartë, El-Mesudi paraqet një tokë të madhe, si dhe identifikon një territor të panjohur të shtrirë përtej oqeanit të errësirës dhe mjegullës. Kjo tokë korrespondon me relievin e sotëm të Amerikës së Jugut. Në këtë hartë ai përshkruan fushat e arit dhe minierat me gurë të çmuar. Në vitin 889, një marinar mysliman i quajtur Ibn Asuad, duke u bazuar në këtë hartë, lundroi nëpër oqeanin e errësirës dhe mjegullës, si dhe u kthye me thesaret prej ari dhe argjendi. Kjo hartë dhe përshkrimet që ndodhën në të, kanë çuar në spekulimet se Amerika ishte e njohur për arabët dhe afrikanët shumë më herët, para se të zbulohet nga Ameriko Vespuçi.

El-Mesudi pretendonte se e kishte vizituar Kinën, por burimi i tetëdhjetë e pestë që ai e liston në fillim të librit të tij, përfshin edhe “Librin e Rrugëve” dhe Realms të Ibn Khurradadhbih. El-Mesudi gjithashtu iu referohet gjeografëve dhe udhëtarëve myslimanë të kohës së tij, si Ebu Zayd, të cilët po ashtu kanë shkruar për popullin kinez, duke theksuar se ky popull ishte një nga shtatë kombet e lashta që ekzistonin para Islamit, të cilët zbritën nga arka e Noas. Të njëjtën gjë për popullin kinez mendonte edhe gjeografi i famshëm mysliman i kohës së mesjetës, Ibn Khurradadhbih. Ndryshe nga ky i fundit, El-Mesudi jep një përshkrim më të detajuar për popullin kinez, duke dhënë si fakte gjeografike, po ashtu edhe origjinën e familjes perandorake kineze, për revoltën e Huang Chao në dinastinë Tang dhe për besimet kineze. Emrat që përdor për këtë familje, janë të vështirë për t’u gjetur në burimet bashkëkohore kineze, prandaj të dhënat që ai përdor, nuk janë shumë të sigurta. Përshkrimi që i bën Azisë Juglindore, shquhet për shkallën e saktësisë dhe të qartësisë. Ai vëzhgoi territore të mëdha të banuara me popuj turq, ku komentoi edhe autoritetin e gjerë që kishte Mbretëria Khakani në këto toka shumë kohë më parë, edhe pse nuk ishte më në kohën e El-Mesudit. Po ashtu, ai tregoi diversitetin e madh të popujve turq, duke përfshirë dallimin në mes turqve rezidentë me atyre

nomadë. El-Mesudi gjithashtu foli edhe për rëndësinë e Khazarëve, duke siguruar materiale të freskëta mbi këtë popull. Për sa i përket territoreve në Gadishullin e Industanit (India e sotme), u dha rëndësi marrëdhënieve ndërshtetërore dhe ndërveprimet mes myslimanëve e hinduve në shtetet e ndryshme të nënkontinentit indian.

Të dhënat për Rusinë, që El-Mesudi i jep në librat e tij, përbëjnë një burim të rëndësishëm për studimin e historisë ruse. Për pasqyrimin e hapësirës ruse ai kishte lexuar shumë nga autorët e tjerë arabë, si: Ibn Fadlan, Ibn el-Fakih, Ibn Rusta dhe Ibn Khurradad. Por shumicën e informacioneve, El-Mesudi i siguroi gjatë vëzhgimeve të drejtpërdrejta që bëri në këto territore, duke pasur kontakte personale gjatë gjithë udhëtimit të tij. Kureshtarëve arabë u tregoi se rusët janë më shumë se disa tregtarë, se ata kishin lidhje tregtare me bizantin dhe zotëronin si anije tregtare, po ashtu edhe anije të mëdha luftarake me vela. Brenda rusëve kishte një shumëllojshmëri popujsh dhe mungonte një autoritet i fortë qendror. Rusët nuk shquheshin për ndjekjen e riteve fetare monoteiste, ku mbizotëronte një përqaftim i fortë i paganizmit. Përsa i përket Detit të Zi dhe Detit Kaspik, në vetvete El-Mesudi ishte i sigurt që këto dy dete ishin të ndarë nga njëri – tjetri nga territore tokësore. Ai bëri përpjekje për të gjetur sa më shumë të dhëna për rajone më të largëta të botës së asaj kohe (në raport me vendet islame). El-Mesudi mblodhi informacione për sllavët, të cilët i trajtoi si popuj të Europës Qendrore dhe Lindore. Parisin e konsideron si kryeqytet francez që në shekullin X, si dhe siguron një kopje të listës me sundimtarët francezë të kohës së tij.

Por nuk ishte shumë i sigurt, sa i përket kontinentit afrikan, ku më shumë është i shqetësuar për atë që po i bënte njeriu mjedisit natyror, siç janë eksportet e lëkurës së xhaguarit, jetën e rinoqerontëve dhe rrjedhën e Nilit, sesa me zakonet e popullsisë. Më pak, ai kishte njohuri për rajonin e Afrikës Perëndimore, edhe pse vetë kishte vendosur emra të tillë si: Zagawa, Kawkaw dhe Gana. Me vëzhgimet e tij, El-Mesudi siguroi të dhëna për kulturat dhe besimet që nuk kishin lidhje me traditën islame. Ai i kushtoi vëmendje të veçantë marrëdhënieve ndërmjet shteteve afrikane në raport me Islamin. Befasuese është mungesa e informacionit mbi Afrikën e Veriut dhe Spanjën, të cilat në atë kohë ishin myslimane.

Një nga gjetjet më mbresëlënëse në shkrimet e El-Mesudit, është teoria e zbulimit të Amerikës para Kristofor Kolombit. Para se të shkonin evropianët, Amerikën e shkelën eksploruesit mesjetarë arabë, aty nga fundi i shekullit IX, të cilët u nisën nga Spanja dhe Afrika, duke rënë në kontakt me popujt indigjenë. Pavarësisht kësaj, këto teori përgjithësisht

nuk merren parasysh nga historianët kryesorë në Europë dhe në Amerikë. Por le të japim disa fakte për mbërritjen e arabëve para evropianëve në Amerikë:

**Së pari:** Dëshmitë e shumta sugjerojnë se arabët nga Spanja dhe Afrika Perëndimore mbërritën në Amerikë pesë shekuj para Kolombit. Detarët arabë lundruan drejt Perëndimit nga porti spanjoll i Delbas, ose i quajtur ndryshe Palos, në Oqeanin Atlantik. Kur u kthyen, morën me vete thesare të mrekullueshme nga një vend i çuditshëm dhe i panjohur. Kurse në hartën që e kishte punuar El-Mesudi për botën e njohur deri në atë kohë, kishte shënuar një zonë të madhe në oqean, përkatësisht në jugperëndim të Afrikës, të cilën ai e quajti “Ard Magjhula”, që do të thotë “territor i panjohur”. Ky mund të jetë një emërtim për Amerikën.

**Së dyti:** Disa studiues, si: Prof. Ivan Van Sertima dhe Shaykh Abdallah Hakim Quick, por edhe botimet e ndryshme myslimane, që nga viti 1996, pohojnë praninë parakolumbiane të myslimanëve afrikanë në kontinentin e Amerikës.

**Së treti:** Traditat gojore, shkrimet akademike, hulumtimet e asaj kohe e deri tek ato të ditëve të sotme, ofrojnë argumente për prezencën myslimane parakolumbiane në kontinentin amerikan.

**Së katërti:** Dëshmitë kulturore, arkeologjike, antropologjike dhe gjuhësore tregojnë prezencën myslimane parakolumbiane në kontinentin amerikan. E çuditshme është se ata që studiojnë provat, e mohojnë vazhdimisht këtë realitet, duke bërë interpretime raciste dhe europiane të historisë amerikane.

**Së pesti:** E rëndësishme është që të mbështetemi te faktet që japin El-Biruni, El-Idrisi, El-Mesudi etj., sepse këta studiues hodhën themelet e shkencave moderne të historisë, gjeografisë, kartografisë dhe lundrimit në det. Këta dy të fundit kanë shkruar për ekskursione transatlantike të Afrikës së myslimanizuar drejt tokave perëndimore. El-Idrisi ka shkruar që nga mesi i shekullit X (viti 956), kurse El-Mesudi që në shekullin XII. Një nga mbretërit myslimanë të Afrikës Perëndimore (Mansa Musa), dha dëshmi të qartë që prej vitit 1324 për udhëtime të tilla, të financuara nga paraardhësi i tij. Nëse shtjellohen dorëshkrimet e epokës së tij, do të nxirren fakte të rëndësishme për historinë dhe gjeografinë e asaj kohe.

Hartat e lashta në gjuhën arabe, fiset amerikane me emra afrikanë dhe fjalët e shkruara qartë në gjuhët e tyre, statujat, ditarët, objektet etj., janë disa prej shumë fakteve që hedhin poshtë idenë e zbulimit të Amerikës nga Kolombi. Këto fakte hedhin poshtë se historia e popujve afrikanë në Amerikë fillon me skllavëri, pas vitit 1500. Studiuesit e sotëm zbulojnë

kuptimin e këtyre fakteve, dhe ndër këta përmendim studiuesit afrikan-amerikanë të besimit mysliman, si: Clyde Ahmed Winters, i cili shkroi artikuj të ndryshëm në revistën “El-Ittihad”, në fund të viteve 1970, duke përfshirë artikuj si “Islami në pjesët veriore dhe në Amerikën e Jugut” dhe “The Influence of Mande Languages on America”; Shaykh Abdallah Hakim Quick (një historian shumë i respektuar) që doktoraturën e përfundoi duke studiuar Afrikën Perëndimore, është autor i veprës “Deeper Roots”; por edhe studiues të tjerë nga kontinenti afrikan, si Dr. Sulayman Nyang, i lindur në Gambi, profesor i studimeve afrikane në Universitetin e Hawardit; Kofi Wangara, si dhe shumë tjerë.

Studiues të tjerë afrikan-amerikanë të besimeve të tjera (jo mysliman), që kanë shkruar për këtë temë, që nga vitet 1920, janë të shumtë. Këtu përfshijmë shkrimet e profesor Leo Weiner, John G. Jackson (“Introduction to African Civilization”, 1937), J.A. Rogers (“Africa’s Gift to America”, 1961), Carter G. Woodson (“The African Background Outlined”), Harold G. Lawrence (“African Explorers of the NewWorld”, 1962) dhe shumë të tjerë.

Leo Weiner ishte autori i parë perëndimor që shkroi për zbulimin e Amerikës, para vikingëve dhe Kolombit. Vepra e tij ishte “Africa and the Discovery of America”, botuar në vitet 1920 – ‘22. Përveç tij, historianë dhe shkencëtarë socialë, të cilët nuk ishin as afrikanë dhe as afrikan-amerikanë, që shkruan për zbulimin e Amerikës para Kolombit, janë: Basil Davidson, Robert Silverburg, Cyrus Gordon, Legrand H. Clegg, Lewis Spence, Barry Fell, Jose V. Pimienta etj.

El-Mesudi ishte edhe një gjeolog dhe mineralog i zoti. Ai studioi tërmetet prej 855 CE, ku dha edhe një teori për tërmetet. Po ashtu, ai prezantoi Teorinë e Evolucionit për mineralet nga bimët dhe kafshët për njeriun duke paralajmëruar Charles Darwin, rreth nëntëqind vjet më parë, për prejardhjen e njeriut.

Ahmed Shboul shprehet se El-Mesudi shquhej për njohuritë që zotëronte rreth vendeve të rajoneve jo islame dhe karakteristikat e popullsisë, duke qëndruar me njohuri shumë më mirë se autorët e tjerë të asaj kohe. Edhe studiuesit e tjerë, duke përfshirë të krishterët që shkruanin në gjuhën arabe, kishin më pak informacione për Perandorinë Bizantine sesa El-Mesudi. Ai ka shkruar shumë për gjeografinë e tokave përtej kalifatit, për zakonet dhe besimet fetare të shumë popujve. Veprat e tij të mbijetuara zbulojnë një mendje shumë intriguese, universale. Shtrirja gjeografike e materialit është me të vërtetë mbresëlënëse.

## El-Idrisi (Dreses) (1099 – 1166)

Ebu Abdullah Muhammed Ibn Muhammed Ibn Abdullah ibn Idris el-Kurtubi el-Hasani, lindi në qytetin Ceuta (ndodhet në territorin e Marokut, por është nën kontrollin e Spanjës). U arsimua në qytetin Kordova të Spanjës. Gjatë kohës së tij, bëri shumë hulumtime shkencore dhe botoi shumë libra në fushën e gjeografisë, hartografisë, biologjisë dhe mjekësisë.

Kontributi i El-Idrisit në zhvillimin e shkencës ishte i madh. Disa studiues e konsiderojnë si gjeografin dhe hartografin më të madh në kohën e mesjetës. Kontributin më të madh në fushën e gjeografisë e dha në Gjeografinë ekonomike, Gjeografinë fizike dhe Gjeografinë kulturore.

Udhëtoi në shumë vende të largëta të botës si në Persi, Europë etj., me qëllim që të mblidhte sa më shumë të dhëna gjeografike. Gjeografët myslimanë të asaj kohe, kishin kryer shumë matje të sakta për sipërfaqen e tokës, duke punuar shumë harta për tërë rruzullin tokësor. Këto të dhëna gjeografike dhe hartografike, El-Idrisi i bashkoi me të dhënat që kishte përfituar nga hulumtimet e tij, duke përfituar të dhëna të reja, shumë më të sakta e të panjohura deri në atë kohë.

Nga njohuritë e fituara prej hulumtimeve të tij në fushat e gjeografisë dhe hartografisë, El-Idrisi tërhoqi vëmendjen e shumë lundërtarëve evropianë, duke fituar një famë të madhe. U bë më i famshëm se disa gjeografë të tjerë myslimanë, për arsye se një pjesë të madhe të jetës e jetoi në Sicili, që asokohe ishte shumë e frekuentuar nga lundërtarët, nga të gjitha anët e botës, pasi Sicilia ndodhet në mes të Detit Mesdhe. Fama e tij bëri që mbreti i Sicilisë, Roxher II, ta ftonte në pallatin e tij për të punuar mbi një Gjeografi universale, të bazuar në të dhënat e vëzhguesve me përvojë. Roxheri II ia besoi misionin El-Idrisit, i cili kishte për detyrë të mblidhte dhe të vlerësonte të gjitha njohuritë gjeografike në dispozicion, si nga librat, ashtu edhe nga vëzhguesit vendorë. Këto të dhëna duhej t'i sistemonte dhe të jepte një pasqyrim më të saktë për botën. Qëllimi i mbretit ishte që këto të dhëna të ishin kryesisht shkencore dhe më pak praktike, duke përpiluar një vepër që do t'i përmbledhte të gjitha njohuritë bashkëkohore të botës fizike. Për të realizuar këtë projekt, Roxheri II themeloi një Akademi gjeografësh, ku vetë ai ishte drejtor dhe El-Idrisi Sekretar i përhershëm, i cili do t'i mblidhte dhe do t'i analizonte informacionet. Roxheri II donte t'i dinte me saktësi rrethanat e çdo zone nën sundimin e tij dhe të botës në përgjithësi, kufijtë e zonave dhe botës, klimat, rrugët, lumenjtë që e ujtinin tokën e tij, si dhe detet që mbulonin



bregdetin. Akademia filloi punën duke i studiuar dhe krahasuar veprat e gjeografëve të mëparshëm dhe prej tyre 12 gjeografë ishin më kryesorët. Nga këta, 10 ishin myslimanë. Disa nga autorët myslimanë, veprat e të cilëve i përdori El-Idrisi janë: Ibn Khurdadhbih, El-Yakubi, Kudamah, Ibn Havkal dhe El-Mesudi. Kurse dy gjeografët nga epoka para islamike që është bazuar El-Idrisi, janë Paulus Orosius dhe Ptolemeu.

Pasi i studiuan me hollësi të gjitha veprat e mbledhura, mbreti dhe El-Idrisi vërejtën se këto vepra kishin mospërputhje dhe lëshime, kështu që vendosën që të nisin kërkime origjinale. I vendosur në Palermo, siç duket kishte një pozitë shumë të leverdishme për ta kryer gjithë punën e tij, ndonëse Sicilia ishte një vendtakim i lundëtarëve nga ujërat e Mesdheut, Atlantikut dhe Veriut. Puna do t'i merrte 15 vjet për ta kryer atë të plotë, siç është shprehur El-Idrisi në hyrjen e tij. Për ta bërë këtë, ekuipazhi dhe pasagjerët e anijeve që u ankoruan në Palermo, Messina, Katania, silleshin në pallatin mbretëror në Palermo për t'u marrë në pyetje nga El-Idrisi apo nga vetë mbreti. Këtyre u bëheshin pyetje rreth vendeve që kishin vizituar, se cila ishte klima e atij vendi, lumenjtë e tij dhe liqenet, malet, konfigurimet bregdetare dhe tokat. Gjithashtu pyetjet ishin edhe për rrugët, ndërtesat, monumentet, të lashtat, zanatet, importet, eksportet, mrekullitë. Informacion kërkonin nga ata edhe se cila ishte kultura, feja, zakonet dhe gjuha e atij vendi. Përveç kësaj, ekspeditat shkencore u dërguan në ato zona për të cilat mungonte informacioni. Hartuesit dhe hartografët i shoqëruan këto ekspedita, në mënyrë që të bëhej një përshkrim vizual i vendit. Ky proces i grumbullimit dhe vlerësimit të materialit zgjati 15 vjet.

Pas pesëmbëdhjetë vjetëve të shoshitjes së këtyre evidencave, filloi që të punohej harta. Duke i ndjekur tabelat që ishin përgatitur, nën drejtimin e El-Idrisit, me ndihmën e një kompasit, filluan që në hartë të vendoseshin vendet e ndryshme. Pas përfundimit të hartës, ai punoi një glob prej argjendi me peshë prej 400 kg. Argjendi u zgjodh si material për arsye të fleksibilitetit dhe qëndrueshmërisë së tij. Në këtë glob paraqiti të shtatë kontinentet e botës, në mënyrë të detajuar (siç janë: malet, rrafshnaltat, lumenjtë, liqenet, rrugët, si dhe qytetet më të mëdha, të shoqëruara me informacione lidhur me gjatësinë, largësinë dhe lartësinë mbidetare). Këtij globi i bashkëngjiti edhe një libër më titull “El-Kitab el-Ruxhari”, kurse Roxher II këtë libër e titulloi “Kitab nuzhat el-Mushtak fi Ikhtirak el-Afak”. Teksti përmbante 71 harta, një hartë botërore dhe 70 harta sektoriale, duke përfaqësuar shtatë klimat, secila e ndarë gjerësisht në 10 seksione. Sa i përket formës së hartës në formë globi, ai shpjegon se globi simbolizon

formën e tokës, sepse toka ka formë të rrumbullakët e cila qëndron pa lëvizur në kozmos “*sikur e verdha në vezë*”, ujërat që ndodhen në të mbahen nëpërmjet një ekuilibri natyror që nuk pëson asnjë ndryshim, kurse ajri e rrethon atë nga gjitha anët. Të gjitha krijesat janë të qëndrueshme në sipërfaqen e tokës, ajri është faktori që e tërheq dritën, kurse toka vetë është e rëndë dhe magneti është ai që e tërheq hekurin. Siç shihet nga komentet e tij, El-Idrisi mendonte se toka ishte e rrumbullakët. Në këtë kohë nuk ishte vetëm ai që kundërshtonte idetë e gabuara që ende ishin populuarizuar deri në kohën e K. Kolombit, se toka ishte e sheshtë. Shumë astronomë të kohës, prej tyre edhe myslimanë, mendonin se toka është e rrumbullakët.

Pas një përshkrimi të shkurtër mbi formën sferike të tokës, të cilën ai e llogariti të jetë 22 900 milje në qark, El-Idrisi me përshkrimin e hemisferave, llojet e klimave, detet dhe gjiret, lëshoi një të dhënë të rëndësishme për rajonin e sipërfaqes së tokës. Ai i ndau shtatë klimat, secilin prej tyre në dhjetë seksione të gjatësisë. Këto shtatëdhjetë seksione ai i përshkruan në detaje, ku secilin përshkrim e ilustron me hartë. Dhe, kur këto harta bashkohen, përbëjnë një hartë botërore drejtkëndore. Përshkrimi i tij nga secila pjesë e ndarë ka një vlerë të veçantë, kur krahasohet me atë të krishterëve, që është në masë më të gjerë, për sa u përket detajeve dhe metodës së tij shkencore. Harta e shkruar në gjuhën arabe, paraqet në tërësi kontinentin euro-aziatik dhe vetëm pjesën veriore të kontinentit afrikan. Veriu në këtë hartë paraqitet në pjesën e poshtme, kurse jugu në pjesën e sipërme. Kjo hartë mbeti si harta më e saktë e botës për tre shekujt e ardhshëm. Libri në fjalë, gjithashtu, përfshin një përmbledhje të njohurive gjeografike dhe sociologjike të kohës së tij, si dhe përshkrimet e udhëtimit të tij të ilustruara me mbi shtatëdhjetë harta. Në Librin “Kharitat el-alam el-ma'mour min el-ard” (Harta e rajoneve të banuara të tokës) ai e ndau botën në shtatë zona, e para që shtrihet nga ekuatori deri në 23 gradë gjerësi dhe e shtata ishte nga 54 në 63 gradë, e pasuar nga një rajon i pabanueshëm për shkak të ftohtit dhe borës.

Pavarësisht deformimeve, lëshimeve dhe keqkuptimeve, superioriteti i hartës së El-Idrisit mbi hartat botërore të Europës mesjetare është shumë e madhe. Në krahasim me hartat origjinale të dijetarëve të krishterë, që më shumë i ngjanin pikturave si dhe ishin shumë të deformuara, tiparet e Europës, Afrikës Veriore dhe Lindjes së Mesme janë lehtësisht të dallueshme në punën e El-Idrisit. Po kështu, në këto harta, më të dallueshme janë edhe Britania, Irlanda, Spanja, Italia, Deti i Kuq dhe Nili.

Libri i Roxherit II, “Kitab nuzhat el-Mushtak fi Ikhtirak el-Afak”, është një ndër librat më të përpunuar të kohës së mesjetës në botë. *“Duke gjykuar për nga niveli i diturisë dhe koncepti i hulumtimit kritik të kohës së tij”*, shkruan Ronarti, *“Libri roxherian i El-Idrizit duhet të shikohet mes arritjeve më të rëndësishme në historinë e shkencës së gjeografisë”*.

Gjatë jetës së tij, El-Idrisi botoi disa libra në fusha të ndryshme, por numri më i madh i këtyre librave janë në fushën e gjeografisë dhe të hartografisë. Më vonë, ai punoi edhe një enciklopedi me njohuri më të zgjeruara dhe me të sakta, të titulluar “Raud-Unas ua-Nuzhat el-Nafs”. Punimet e tij rreth Nigerit të sipërm, Timbuktusë, dhe ujërave të Nilit në Sudan, ishin të njohura për saktësinë e tyre. Disa nga librat e tij u përkthyen në gjuhën latine. Dhjetë kopje të dorëshkrimeve të librit të Roxherit vazhdojnë të ekzistojnë edhe në këtë kohë. Dy kopje janë në bibliotekën e quajtur “Bibliothèque Nationale de France”, duke përfshirë edhe kopjen më të vjetër (rreth 1300 vjeçare). Një kopje tjetër e prodhuar në Kajro, në vitin 1456, gjendet në bibliotekën “Bodleian” të Oksfordit. Puna e El-Idrisit shënon një epokë në historinë e shkencës, në gjallërinë e përshkrimit, në detajet e përpikta, në vlerësimin korrekt të hapësirës, dhe kjo është një ndër krijimet më të shquara letrare në kohën e mesjetës. Rëndësia e saj qëndron jo vetëm në të dhënat historike më të vlerësuara dhe më interesante, por edhe në përshkrimet e shumë pjesëve të tokës, të cilat akoma janë të besueshme. Për tre shekuj, gjeografët kopjuan hartat e tij pa ndonjë ndryshim. Pozita relative e liqeneve që përbëjnë Nilin, si një përvijim në punën e tij, nuk ndryshon shumë nga ajo e Bejkërit dhe e Stenlit, pas më shumë se shtatëqind viteve.

Librat e tij në fushën e gjeografisë ishin të njohur për shumë shekuj me radhë dhe përkthimi i njërit prej librave të tij u publikua në Romë.

## Bibliografia

1. Dr .W.Hazmy C.H. Dr Zainurashid Z. Dr Hussaini R., BIOGRAPHY Muslim Scholars and Scientists, Published by: Islamic Medical Association of Malaysia N. Sembilan, (<https://docs.google.com/file/d/0B-e6qHPbxSdNd1oxMUVCVG82a0E/edit>)
2. Dr. Muhammad Adil Afridi, CONTRIBUTION OF MUSLIM SCIENTISTS TO THE WORLD: AN OVERVIEW OF SOME SELECTED FIELDS ([http://irep.iium.edu.my/8415/1/Contribution\\_of\\_Muslim\\_Scholars\\_to\\_the\\_world.pdf](http://irep.iium.edu.my/8415/1/Contribution_of_Muslim_Scholars_to_the_world.pdf)), M.sc. Artan S. Mehmeti, “Të kërkuarit e diturisë sipas Islamit”, EDU-

KATA ISLAME, nr. 107, Prishtinë 2014, M.sc. Artan S. Mehmeti, “MYSLIMANET QË KONTRIBUAN NË ZHVILLIMIN E SHKENCËS SË GJEOGRAFISË”, EDUKATA ISLAME, nr. 110, Prishtinë 2016, al-Mas’ūdī - HISTORIAN OF CIVILISATIONS, (<http://www.iais.org.my/e/attach/al-Mas’udi%20Historian.pdf>),

3. AL-MASUDI’S UNIVERSAL HISTORY: “A DIALOGUE OF CIVILIZATIONS”, By Pierre Beaudry, 2/7/2016, ([http://amaterofmind.org/Pierres\\_PDFs/HISTORY%20/BOOK\\_I/22.\\_AL\\_MASUDI’S\\_UNIVERSAL\\_HISTORY\\_A\\_DIALOGUE\\_OF\\_CIVILIZATION%20%20.pdf](http://amaterofmind.org/Pierres_PDFs/HISTORY%20/BOOK_I/22._AL_MASUDI’S_UNIVERSAL_HISTORY_A_DIALOGUE_OF_CIVILIZATION%20%20.pdf)), [http://www.bahaistudies.net/asma/al\\_masudi-arabic.pdf](http://www.bahaistudies.net/asma/al_masudi-arabic.pdf), <http://www.myoldmaps.com/early-medieval-monographs/212-massaudy-world-map/212-masudi.pdf>,<https://historyofislam.com/contents/the-classical-period/al-masudi/>
4. <http://www.muslimheritage.com/scholars/al-masudi>, s.MAQBUL AHMAD, 7 • Cartography of al-Sharīf al-Idrīsī ([http://www.press.uchicago.edu/books/HOC/HOC\\_V2\\_B1/HOC\\_VOLUME2\\_Book1\\_chapter7.pdf](http://www.press.uchicago.edu/books/HOC/HOC_V2_B1/HOC_VOLUME2_Book1_chapter7.pdf)), [http://cartographic-images.net/Cartographic\\_Images/219\\_al-Idrisi.html](http://cartographic-images.net/Cartographic_Images/219_al-Idrisi.html), <https://www.thefamouspeople.com/profiles/muhammad-al-idrisi-7511.php>,
5. <https://science.missouristate.edu/assets/science/PosterMuhammadAl-Idrisi.pdf>, <http://www.environment.gen.tr/geographers-and-explorers/566-muhammad-al-idrisi.pdf>.